

Raport mbi zhvillimet ne Arsimin e Larte ne Shqiperi dhe programi i Ministrise se Arsimit dhe Shkences

Edmond Hajdëri

(Drejtor i Drejtorise se Arsimit te Larte ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences)

Sistemi i Arsimit te Larte ne varesi te Ministrise se Arsimit dhe te Shkences perbehet nga 11 shkolla te larta. Ne te bejne pjese 8 universitete (U.Tiranes, U.Politeknik, U.Shkodres, U.Bujqesor, U.Elbasanit, U.Korçes, U.Vlores, U.Gjirokastrës) dhe 3 shkolla te larta (A. Arteve te Bukura, Sh. Larte e Infermierise, I. Kultures Fizike), pa permendur ketu shkollat e larta ushtarake te cilat nuk jane ne varesi te Ministrise se Arsimit dhe Shkences.

Arsimi i Larte ne Shqiperi vazhdon te karakterizohet nga nje numer mjaft i ulet i studenteve per fryme te popullsise (1% - viti akademik 1997-1998) shifer kjo qe zbret ne 0.5% ne qofte se do t'i referoheshim vetem numrit te studenteve me shkeputje nga puna.

Numri i vogel i studenteve, qe kemi sot ne shkollat e larta vazhdon te kushtezohet nga niveli i ulet i zhvillimit ekonomik te vendit. I ulet vazhdon te mbetet edhe raporti i buxhetit te Arsimit te Larte perkundrejt atij te Arsimit ne pergjithesi (9.9% ne 1998). Si rrjedhim dhe investimet per zgjerimin e institucioneve ekzistuese jane mjaft te kufizuara (8.6% te buxhetit te Arsimit te Larte ne 1998), dhe vazhdojne te kushtezojne rritjen e numrit te studenteve dhe aplikimin e sistemit te pranimeve me numer te mbyllur ne shkollat e larta, sistem qe sherben nderkohe edhe si filter cilesie. Per pasoje e ulet eshte dhe terheqja e nxenesve nga arsimi i mesem ne ate te larte. Per vitin akademik 1997-98 munden te hyjne ne shkollat e larta vetem 32% e nxenesve qe mbaruan shkollat e mesme nderkohe qe kerkuan te vazhdojne studimet e larta 65.3% e maturanteve.

Ne strukturen aktuale te Arsimit tone te Larte, nje nga fenomenet me shqetesuese eshte numri i madh i studenteve te sistemit pa shkeputje nga puna, ose siç quhet ndryshe e studimeve me korrespondence, ne raport me ate te sistemit me shkeputje nga puna (ose ditën), karakteristike kjo qe e dallon mjaft arsimin tone universitar nga ai i disa vendeve te tjera europiane. Nga 35900 studente qe kemi te regjistruar per kete vit akademik ne shkollat tona te larta, 17350 ose 48.2% e studenteve i perkasin sistemit me shkeputje nga puna (fig.1).

Gjate ketyre viteve te fundit ky numer ka qene ne rritje, pasi studimet pa shkeputje nga puna kane qene konsideruar si menyra me e mire per te rritur numrin e studenteve me kosto sa me te ulet (me sa me pak pedagoge), pa mare ne konsiderate se cilesia e formimit te studenteve ne kete sistem eshte me e ulet se sa ajo e studenteve me shkeputje nga puna (fig.2).

Kjo strategji, e cila deri tani mund te konsiderohej pozitive nga pikpamja sasiore dhe financiare, ka bere qe te kemi nje ulje te ndjeshme te nivelit te cilesise se formimit te specialisteve. Do te ishte e tepert te permendnim faktin se cilesia e studenteve qe ndjekin sistemin e korrespondences eshte me e ulet se ajo e studenteve te dites. Po ashtu me i ulet eshte dhe niveli i formimit te tyre per shkak te mosndjekjes se leksioneve. Ne keto kushte, studentet e te dy sistemeve, pavaresisht nga keto diferenca te ndjeshme, vleresohen njelloj dhe marrin te njejten diplome, e cila ne rrethanat e nje subjektivizmi administrativ dhe politik mund te shoqerohet me pasoja. Ne planin nderkombetar, organizma te ndryshem nderkombetare, te specializuar ne fushen e njohjes se diplomave, kerkojne informacion mbi ndryshimet midis te dy sistemeve te diplomimit. A do te ishte e drejte qe t'ju pergjigjemi se zyrtarisht nuk ka asnje diference?

Shembulli me eklatant, lidhur me marredheniet midis cilesise dhe raportit te studimeve ditën/korrespondence, eshte ai i studimeve ne fushen e Drejtesise. *Pergatitja e juristeve konsiderohet nje çeshtje mjaft e rendesishme qe ka te beje direkt jo vetem me te ardhmen e shtetit ligjor por edhe te shtetit ne pergjithesi. Per nga rendesia, ajo konsiderohet nje fushe strategjike studimesh.*

Ne Universitetet e Tiranes, Elbasanit dhe te Shkodres, ku ka dege Drejtesie, aktualisht studojne gjithsej rreth 8000 studente, nder te cilet rreth 1600 me shkeputje nga puna dhe rreth 6400 pa shkeputje nga puna ose me korrespondence, shifer kjo e dyfishuar brenda ketyre 3 viteve te fundit (fig.3). Ne keto kushte, nuk do te ishte e veshtire te kuptohej niveli i pergjithshem profesional i formimit te mases se juristeve te ardhshem. *Eshte ne interes te zhvillimit te vendit qe ne kurse te tilla studimi, pra te nje rendesie te veçante, te kerkohet cilesia dhe jo masiviteti.*

Duke u nisur nga ky rast dhe nga te tjere te ngjashem, Ministria e Arsimit dhe e Shkences, pas konsultimesh te gjera me specialiste te fushes, me dikasteret e interesuara si Ministria e Drejtesise dhe Ministria e Reformes Institucionale, si dhe me konsensusin e plote te organizmave nderkombetare veçanerisht te interesuara ne kete fushe si Banka Boterore, ka vendosur te mbylle perfundimisht kursin e Drejtesise ne sistemin pa shkeputje nga puna (me korrespondence) ne te tre universitetet ku ky sistem ekziston. Perveç kesaj do t'i sugjeronim Ministrise se Drejtesise qe, brenda nje kohe sa me te shkurter, te organizonte testimin, me nje komision te posaçem akademik, e te gjithë te diplomuarive ne Drejtesi gjate ketyre viteve ne sistemin e korrespondences, per te percaktuar ata qe meritojne diplomën e juristit.

Mbi bazen e gjithë ketyre elementeve, duke e konsideruar çeshtjen e cilesise si paresore ne formimin e specialisteve te ardhshem, do te synohet qe brenda nje kohe te shkurter, sistemi i studimeve me korrespondence te reduktohet drejt nje minimumi per te gjitha kurset e studimit, duke filluar te zbatohet kjo qe nga viti i ardhshem akademik 1998-1999. Zvogelimi i numrit te studenteve mendohet te kompensohet me hapjen e kurseve te reja, sidomos ne arsimin e larte jo-universitar si dhe me zgjerimin gradual te kurseve universitare ekzistuese te sistemit te dites atje ku kjo eshte e mundur. Ne vitet e ardhshme pozitivisht mund te ndikojne ne kete plan edhe futja e arsimit te larte privat, i cili, persa i perket cilesise se procesit pedagogjik, do te jete nden nje kontroll te vazhdueshem e rigoroz nga shteti.

Nje karakteristike tjeter e fizionomise se Arsimit te Larte ne vendin tone, eshte dominimi i arsimit universitar ne raport me ate jo-universitar dhe shkalla e ulet e zhvillimit te ketij te fundit, krejt ndryshe nga sa verehet ne vendet te tjera si Anglia, Gjermania, Italia etj. ku arsimi i larte jo-universitar eshte mjaft i zhvilluar. Ne vendin tone, arsimi i larte jo-universitar perfaqson nje element te ri te futur ne vitin 1994. Ai zhvillohet vetem me shkeputje nga puna dhe frekuentohet nga vetem 6.4% e numrit te pergjithshem te studenteve ose 12.2% e studenteve te dites.

Diferenca ne zhvillimin e te dy tipeve te Arsimit te Larte ne vendin tone shprehet edhe ne numrin e kurseve te studimit. Nga rreth 60 kurse studimi qe kemi sot ne te gjitha shkollat tona te larta, vetem 3 prej tyre jane jo-universitare (Infermiera, Cikli i Ulet dhe ai Parashkollor), nderkohe qe ne Itali nder 174 kurse studimi qe ekzistojne, 89 jane jo-universitare (pra rreth 50%). Per kete vit universitetet tona ne rrethe kane kerkuar hapjen e 8 kurseve te reja jo-universitare.

Duke e konsideruar kete lloj arsimimi si nje nga alternativat me efikase te diversifikimit te arsimit te larte e sidomos te atij profesional aplikativ per shkak te ciklit me te shkurter te studimeve, orientimit praktik dhe per pasoje te afrimit te shpejte me kerkesat e tregut te punes, mendojme se zgjerimi dhe konsolidimi i arsimit te larte jo-universitar ne universitetet e rretheve do te ishte nje nga strategjite me te pershtatshme ne drejtim te:

- a) rritjes se numrit te studenteve ne raport me numrin e popullsisë dhe me ate te shkollave te larta (aktualisht kemi 11 shkolla te larta me vetem 35 900 studente me dhe pa shkeputje nga puna);
- b) kualifikimit e punesimit te shpejte te brezit te ri dhe nxitjes se zhvillimit ekonomik ne ato zona;
- c) orientimit me te qarte te zhvillimit te universiteteve te rretheve mbi bazen e kerkesave dhe karakteristikeve te zhvillimit rajonal.
- d) shperndarjes me uniforme te studenteve ne te gjithë territorin, element ky qe do te varet shume nga cilesia e kurseve te studimit qe do te ofrojne shkollat e larta (ne Tirane eshte perqendruar 66% e studenteve qe ndjekin studimet ne sistemin me shkeputje nga puna) (fig.4).

Sistemi yne universitar karakterizohet gjithashtu nga nje dinamizem i shpejte, gje qe eshte pasqyruar ne ritmet e zhvillimit te kurrikulave ekzistuese dhe ne futjen e atyre te reja. Kjo pasqyrohet edhe ne kerkesat e shumta per kurse te reja studimi si dhe per profilizimin e atyre ekzistues. Ndersa persa i perket strukturave te reja, eshte kerkuar hapja e 5 fakulteteve dhe 16 departamenteve te reja.

Kerkesat per kurse dhe struktura te reja, vijne kryesisht nga universitetet e rretheve te cilat kerkojne te zgjerohen per te patur nje fizionomi me te plote dhe per te terhequr me shume interesimin e te rinjve ne kryerjen e studimeve ne ato zona. Duket qarte konturimi i nje konkurrence nderuniversitare gje qe e konsiderojme pozitive, por kjo duhet vleresuar me shume kujdes ne nivel kombetar pasi ka te beje me te ardhmen si te ketyre institucioneve ashtu dhe te Arsimit te Larte ne vendin tone.

Eshte evidente dhe tendenca e universiteteve te rretheve per futjen e kurseve te reja universitare ose te profilizimit te atyre ekzistues ne vitet e III e te IV, megjithese ne

disa prej tyre nuk ka perfunduar akoma brezi i pare i te diplomuarve. Profilizimet qe kerkohen mund t'i grupojme ne dy kategori:

- a) Ne njeren kategori mund te grupohen profilizimet qe kerkohen brenda degeve te mesuesise. Universitetet e rretheve, qe formojne mesues per arsimin 8 vjeçar, kerkojne profilizimin e mesuesve te matematike-fizikes ne mesues matematike dhe fizike, te atyre te histori -gjeografise ne mesues historie dhe mesues gjeografie e po keshtu edhe per mesuesit e biologji - kimise. Ky profilizim qe kerkohet aktualisht bie ne kontradikte me shperndarjen kapilare te arsimit 8 vjeçar ne vendin tone.
- b) Ne kategorine tjeter perfshihen profilizimet qe kerkohen si pasoje e kerkesave te reja te tregut te punes. Te gjitha universitetet qe kane dege mesuesie ne gjuhe te huaj kerkojne profilizimin e kesaj diplome ne dy drejtime, mesues te gjuhes se huaj dhe perkthyes, nderkohe qe ne disa raste kerkohet dhe nje profil te trete, ai i specialistit te gjuhes se huaj.

Problemet e mesiperme lidhur me ristrukturimin e shkollave te larta dhe me profilizimin e kurseve te reja duhen vleresuar ne planin e nje politike kombetare. Ne perpunimin dhe ndjekjen e nje strategjie te zhvillimit te Arsimit te Larte ne Shqiperi eshte ndjere mungesa e nje organi kolektiv te posaçem, i cili eshte parashikuar qe nga viti 1994 me aprovimin e Ligjit per Arsimin e Larte (Keshilli Kombetar i Shkollave te Larta) por qe nuk ka funksionuar.

Per te ardhmen, eshte e domosdoshme perpunimi i nje strategjie afatmesme dhe afatgjate te zhvillimit te Arsimit te Larte ne Shqiperi, gje qe mund te behet vetem mbi bazen e nje parashikimi dhe orientimi te qarte mbi te ardhmen e zhvillimit ekonomik afatmesem dhe afatgjate te vendit. Nga pikapamja organizative, ristrukturimi kerkon hartimin dhe zbatimin e standarteve te caktuara ne percaktimin e strukturave perberese te shkollave te larta.

Diversiteti ne Arsimin tone te Larte ne disa raste eshte aq i madh sa qe behet i papranueshem per nje vend te vogel si ky i yni. Per shembull, Infermieria si kurs studimi jo-universitar me kohezgjatje 3.5 vjet, aktualisht zhvillohet ne tre struktura te ndryshme per nga forma administrative: Shkolla e larte e Infermierise ne Tirane, Fakulteti i Infermierise ne Vlore dhe Dega e Infermierise prane Universitetit te Korçes.

Kjo situatë si dhe *shume probleme, kontradikta e anomali te tjera qe verehen ne sistemin tone arsimor burojne nga fakti se ne zhvillimin e Arsimit ne pergjithesi dhe te atij te larte ne veçanti, ne Shqiperine e pasluftes e deri sot, nuk eshte marre asnjehere per baze dhe nuk eshte aplikuar nje model i vetem arsimor. Kjo ka bere qe modeli yne arsimor te jete nje mozaik ose nje rezultante e kombinimeve te modeleve te ndryshme te huaja me pervojen arsimore kombetare te nje vendi qe deri ne luften e II Boterore nuk kishte asnje universitet apo shkollë te larte. Ky mozaik, ne Arsimin e Larte ka qene mjaft i dukshem si ne zhvillimin e kurrikulave ashtu dhe ne aspektin e zhvillimit institucional, gje qe eshte kushtezuar nga faktore politike, historike dhe nga orientimi kulturor i stafit akademik.*

Si rrjedhim, per plotesimin e kerkesave te ndryshme te zhvillimit te vendit, ne fushen e Arsimit e ne ate te Arsimit te Larte ne veçanti, eshte eksperimentuar ne te gjitha drejtimet, duke u perpjekur te gjenden rruge origjinale, duke bere arnime dhe modifikime te vazhdueshme jo organike gje qe ka rritur mjaft kompleksitetin dhe ka veshitresuar gjetjen e zgjidhjeve te shpejta e adekuate. Kjo verehet si ne arsimin

parauniversitar ashtu dhe ne ate universitar e pasuniversitar, e deri ne sistemin e klasifikimit te punonjesve pedagogjike e shkencore. Mosperputhjet evidentohen me shume tani kur kerkohet te harmonizohen elementet e ndryshem e sistemit tone arsimor dhe kur fluksi migrator e ka detyruar ate te krahasohet me sistemet e huaj per njohjen e diplomave te shtetasve tane qe shkojne per te punuar jashte ose te atyre qe kthehen ne Shqiperi pas kryerjes se studimeve te larta ne vendet e tjera.

Mbase ka ardhur koha qe te diskutojme per te ardhmen: a do te vazhdojme keshtu siç eshte ecur deri tani apo do te zgjedhim dhe do te zbatojme nje model te vetem zhvillimi per arsimin ne teresi dhe per ate te larte ne veçanti, ate qe mund te jete me i pershtateshmi per kushtet tona?

Kjo mund te jete nje nga alternativat qe do te ofronte nje zgjidhje te menjehershme per te gjitha problemet e Arsimit ne pergjithesi duke perfshire edhe ato te Arsimit te Larte, pasi do te behej fjale per zbatimin e modeleve organike, te studjuara dhe te kolauduara nga vende te tjera me nje eksperience me te madhe arsimore.

Aktualisht ndodhemi perpara nje situate kur krahas zgjerimit te universiteteve te rretheve e permiresimit te kurrikulave kerkohet njkohesisht dhe kualifikimi sa me i shpejte i stafit te tyre akademik. Nje nga pengesat kryesore per zgjerimin e universiteteve te rretheve eshte edhe mungesa e stafit akademik te kualifikuar. Pjesa me e madhe e pedagoqeve jane pa tituj e grada shkencore (U.Vlores - 92%, U.Elbasanit dhe U.Gjirokastres 75%, U.Shkodres 64%, U. Korçes 61%) (fig.5). Ne keto kushte do te ishte i nevojshem zgjerimi i marredhenieve dhe i mobilitetit me universitetet e tjera te huaja ne kuadrin e marreveshjeve dypaleshe. Zgjidhja e ketij problemi eshte veshtiresuar edhe nga zvogelimi i ndjeshem kete vit i Programit Tempus per Shqiperine nga 2.5 ne 0.7 MECU.

Si mundesi e brendshme mbetet perfshirja e stafit te ri ne kualifikimin pasuniversitar (SHPU). Per kete eshte sugjeruar qe ndjekja e SHPU me korrespondence te jete nje perjashtim vetem per pedagoget e shkollave te larta.

Nje burim i brendshem qe mund te ndikoje ne permiresimin e cilesise se mesimdhenies ne universitetet e rretheve eshte dhe rritja e angazhimit te perkohshem te pedagoqeve nga universitetet e Tiranës, ne zhvillimin e kurseve te reja te studimit, gje qe mund te realizohet me sistem modulesh ose cikle leksionesh, por qe kerkon fonde shtese.

Nje nga treguesit e Arsimit te larte eshte dhe raporti midis numrit te studenteve dhe numrit te pedagoqeve. Tek ne, duke perfshire ketu edhe studentet e korrespondences, keto vitet e fundit ai eshte luhatur nga 18.8 ne 19.8 studente/pedagog. Ky tregues eshte me i mire ne raport me vende te tjera te Komunitetit European (35.6 st/ped) ku frekuentimi i lire pa detyrime vjetore ka sjelle kohezgjatjen e ndjeshme te studimeve. Ne kete aspekt, mund te konsiderojme element pozitiv sistemin tone te provimeve vjetore te detyrueshme ne krahasim me sistemin e lire te provimeve qe zbatohet ne pergjithesi ne vendet e tjera.

Vitet '90 ne Arsimin e Larte ka qene karakterizuar edhe nga nje ndryshim i ndjeshem i preferencave te studenteve ne frekuentimin e kurseve te studimit. Nder

shkollat e larta, ku numri i studenteve eshte zvogeluar ndjeshem, jane Universiteti Bujqesor i Tiranës (-5 here), Universiteti Politeknik i Tiranës (-2.4 here) dhe Akademia e Arteve (-1.6 here). Per fakultete te veçanta kjo renie ka qene drastike. Me te prekurit kane qene Fak. i Inxhinierise Mekanike te UPT dhe Fak. i Veterinarise i UBT ku numri i studenteve eshte zvogeluar 8 here. Rreth 5 here eshte ulur numri i studenteve edhe ne Fak. Gjeologji-Miniera te UPT e ne Fak. e Agronomise te Universitetit te Korçës.

Kuptohet qe keto jane rezultat i ndryshimeve te medha te struktures se ekonomise shqiptare te ketyre viteve, e cila u karakterizua nga mbyllja pothuajse e plote e industrise mekanike dhe e mjaft industrive te tjera si dhe nga mbyllja e kooperativave bujqesore dhe renia ne minimum i prodhimit bujqesor vendas.

E kunderta eshte verejtur me fakultete te tjera si ata te Drejtesise, te Ekonomikut, te Mjekesise, te Arkitektures, te Gjuheve te Huaja, qe konsiderohen si fakultete te preferura, ku jane perqendruar pjesa me e madhe e kerkesave per shkak te perfitimeve materiale ne ushtrimin e profesionit.

Nje nga dobesite kryesore te Arsimit tone te Larte, qe vazhdon t'a diferencojate ne raport me Arsimin e Larte te vendeve te tjera, eshte aktiviteti mjaft i kufizuar kerkimor i stafit akademik, gje qe ka qene me e theksuar sidomos ne sektoret eksperimentale e teknike, duke bere qe aktiviteti kryesor te kufizohet kryesisht ne planin pedagogjik. Per pasojte misioni i universitetit, ne shume fakultete, eshte perqendruar vetem ne planin mesimor duke çuar ne humbjen e fizionomise se universitetit si qender e mesimit dhe e kerkimit shkencor. Reduktimi i aktivitetit kerkimor veçanerisht ne shkencat e aplikuara dhe ne ato teknike, i lidhur kryesisht me faktore financiare institucionale, me mungesen e bazes se nevojshme laboratorike si dhe me pamundesine per t'u integruar ne shume nga programet kerkimore te Komunitetit European, ka bere qe te mbetet i pashfrytezuar potenciali intelektual i universiteteve tona.

Nuk mund te stimulohet aktiviteti kerkimor dhe as te zhvillohet ai pa nje minimum te domosdoshem pajisjesh laboratorike, per te mos permendur ketu pagat, niveli i ulet i te cilave ka çuar ne zbrazjen e universiteteve.

Aktiviteti i kufizuar kerkimor i pedagoqeve ka ndikuar gjithashtu edhe ne angazhimin mjaft te kufizuar te studenteve ne fushen eksperimentale dhe ne edukimin e tyre te manget me elementet fillestare te kerkimit shkencor, krejt ndryshe nga sa verehet ne universitetet e tjera europiane ku studentet, ne periudhen e pergatitjes se tezes se diplomes, jane pjese e stafit kerkimor te pedagoqeve. Nuk duhet harruar se perveç aspektit te formimit, ky eshte momenti kryesor edhe per evidentimin e cilesive individuale dhe stimulimin e diferencuar e shkencetareve te ardhshem.

Ne planin material, Ministria e Arsimit dhe e Shkences organizoi gjate ketyre muajve vlersimin e nevojave imediate dhe afatgjata te shkollave te larta. Vetem per pajisje laboratorike dhe lende te para nevojat imediate arrijne ne rreth 5 milion US \$. Afersisht po 5 milion US \$ vleresohen edhe ato afatgjata. Ne vlere absolute keto shifra mund te jene te larta, por angazhimi i njekohshem i mundshem i disa donatoreve mund ta lehtesoje mjaft procesin e plotesimit te shkollave tona te larta me pajisjet e nevojshme laboratorike per procesin mesimor dhe kerkimin shkencor.

Nje nga faktoret qe mund te kene influencuar ne renien e cilesise se aktivitetit kerkimor ka qene edhe thjeshtimi i sistemit te kualifikimit shkencor. Unifikimi ne vitin 1993 i gradave *Kandidat i Shkencave* me *Doktor i Shkencave* u shoqerua ne me te shumten e rasteve, me nje masivitet te dizertacioneve dhe me nje renie te interesimit per te vazhduar me tej punen kerkimore. Ndersa per periudhen 1975-1993 kishim 201 doktore dhe 1998 kandidate shkencash (pra gjithsej rreth 2200 disertacione ne 18 vjet), ne periudhen 1993-97 jane realizuar 697 disertacione, pra rreth 30% me shume per 4 vjet ! Unifikimi i gradave dhe eliminimi nga obligimi per shkallen e dyte, i çliroi studjuesit nga ky detyrim dhe beri qe te kete nje renie te interesimit per te vazhduar punen kerkimore.

Nje nga mangesite qe vihet re ne kerkimin shkencor, jo vetem ne universitete por edhe ne institucionet tona kerkimore, eshte mungesa e ndermarrjes se studimeve te integruara, gje qe kerkon nivel te larte pergatitjeje te te gjithe ekipeve pjesmarres dhe kompletim te njekohshem me pajisje te tyre. Kombinimi i kapaciteteve intelektuale e teknike te universiteteve me ato te institucioneve kerkimore do te ishte nje faktor favorizues. Per kete pozitivisht do te kishte influencuar realizimi i integritimit institucional, mbase gradual dhe ne forma te pranueshme, i Arsimit me Shkencen, gje per te cilen misioni i Keshillit te Evropes i vitit 1996 ka dhene rekomandime te qarta.

Po ashtu negativisht ka influencuar dhe mosndarja e deritanishme e buxhetit te universiteteve ne zera te veçanta per mesimin dhe kerkimin shkencor.

Per kapercimin e kesaj suate te veshtire ne sektorin e kerkimit shkencor universitar, mendojme se *nje nga rruget me te shpejta dhe te efektshme, krahas perpjekjeve institucionale per te kompletuar bazen laboratorike, do te jete ajo e bashkepunimit me universitetet e tjera europiane ne fushen e kerkimit shkencor, ne organizimin dhe realizimin e perbashket te projekteve kerkimore komplekse.*

Nuk mund te harrojme se nuk ka universitet pa kerkim shkencor, prandaj dhe ministria se bashku me universitetet, eshte impenjuar ne te gjitha drejtimet per te stimuluar çdo lloj forme te bashkepunimit me institucionet e huaja per arritjen e ketij objektivi.

Mungesa e nje ekonomie te zhvilluar ne vendin tone ben gjithashtu qe universitetet shqiptare te mos kene mundesi te shfrytezojne alternativa te tjera te sigurimit te burimeve financiare siç mund te ishte ajo e bashkepunimit reciprok me industrine ose me konsorciumet e ndryshme. Pritet qe rritja e autonomise do te influencoje pozitivisht ne kete drejtim.

Ne problematiken e sistemit tone universitar, vazhdon te mbetet akoma evidente *prania nje sistemi te kualifikimit pasuniversitar te pakonsoliduar dhe te paorganizuar mire. Duke e konsideruar kualifikimin pasuniversitar si hallke te Arsimit te Larte, po punohet qe te permiresohet legjislacioni ekzistues ne menyre qe ky sistem te perbeje nje instrument efektiv te plotesimit dhe thellimit te metejshem te kultures universitare per t'ju pergjigjur nevojave te zhvillimit per specialiste te kualifikuar.*

Rastet e kurseve te kualifikimit pasuniversitar qe funksionojne jashte sistemit universitar (siç jane Kursi i Magjistratures dhe Kursi i Eksperteve Kontabel), shtrojne pyetjen: a do te kemi kualifikim pasuniversitar jashte sistemit universitar?

Te meta verehen edhe ne sistemin e shkollave pasuniversitare (SHPU), hapja dhe funksionimi i te cilave deri tani nuk eshte mbeshtetur ne kriteret e unifikuara. Ne kete drejtim mendojme se *ngritja e SHPU-ve duhet te jete rezultat jo vetem i iniciatives dhe interesave institucionale por dhe i gershetimit te tyre me politiken shkencore kombetare, ne funksion te zhvillimit te vendit*. Nga diskutimet e organizuara me shkollat e larta per kete problem, doli qarte nevoja e nje riorganizimi te SHPU-ve mbi bazen e kriterëve dhe standarteve te unifikuara si dhe rritja e rigorozitetit dhe e cilesise se realizimit te tyre. Per kete do te perpunohet nje rregullore e veçante ndersa ndjekja e SHPU me korrespondence do te jete perjashtim vetem per pedagoget e shkollave te larta.

Rendesi i eshte kushtuar kete vit akademik hapjes se kurseve te kualifikimit pasuniversitare ne bashkepunim me universitete te huaj. Per vitin akademik 1998-99 do te kete edhe 2 kurse te tilla: i pari do te jete 2 vjeçar dhe do te funksionojne prane Fakultetit te Drejtësisë te UT per kualifikimin e juristeve dhe ekonomisteve ne te drejten e krahasuar dhe ne te drejten europiane, ndersa i dyti do te jete 1 vjeçar dhe do te funksionojne prane Universitetit Politeknik ne fushen e menaxhimit te ndermarrjeve.

Nje problem i rendesishem, qe sot ka hyre ne rrugen e zgjidhjes, eshte dhe ai i autonomise institucionale. Ne kete kontekst po rishikohet legjislacioni ekzistues per t'a ngritur ate ne standartet europiane duke e permireshuar veçanerisht ne drejtim te autonomise financiare, e cila do t'u garantoje fakulteteve dhe departamenteve nje hapesire me te madhe ne perdorimin e burimeve financiare. Por, nga ana tjetër, rritja e shkalles se autonomise duhet te shoqerohet si me rritjen e shkalles se kontrollit nga rektoratet drejt niveleve me te uleta (fakultet e departament) per shfrytezimin e drejte te burimeve financiare ashtu dhe me rritjen e shkalles se pergjegjesise te drejtuesve te fakulteteve e departamenteve per t'i shfrytezuat me sa me efektivitet keto burime ne funksion te proçesit mesimor e te kerkimit shkencor.

Nje element qe mund te influenconte pozitivisht ne administrimin e burimeve financiare, do te ishte prania, ne strukturat administrative te shkollave te larta, e administratoreve te diplomuar ose te kualifikuar ne fushen e menaxhimit dhe jo vetem e ekonomisteve te thjeshte.

Nje nga aspektet e rendesishem ku po punohet aktualisht ne Arsimin e Larte eshte futja e elementeve te rendesishem te standartit nderkombetar si sistemi i akreditimit institucional dhe ai i njohjes se diplomave, i viteve te studimit dhe i gradave e titujve shkencore, akademike e profesionale.

I pari do te çojte drejt nje vleresimi real e te vazhdueshem te gjendjes se institucioneve te Arsimin te Larte dhe atyre kerkimore nepermjet aplikimit te kriterëve nderkombetare dhe jo subjektive te vleresimit, ndersa i dyti do te lehtësoje dhe do te favorizojë ne menyre te ndjeshme mobilitetin e studenteve dhe te te diplomuarve nepermjet zvogelimit te barrierave reale qe ekzistojne ne kete drejtim.

Rezultat final parashikohet permiresimi i cilesise se institucioneve, rritja e kredibilitetit institucional te sistemit tone te Arsimit te Larte dhe integrimi i tij me i lehte ne planin nderkombetar .

Te gjitha keto padyshim do te influencojne ne permiresimin e nivelit aktual te sistemit te Arsimit te Larte ne Shqiperi dhe do t'i krijojne kushte dhe hapësira te reja initiatives institucionale dhe bashkeveprimit aktiv nderuniversitar.

Tirane, 26 qershor 1998